



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIATI / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 24 dhjetor 2012
Nr. ref.: RK333/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI164/11

Parashtrues

Jetullah Mustafa

Vlerësim kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 538/2008, të datës 28 qershor 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Kadri Kryeziu, gjyqtar.

Parashtruesi

1. Parashtrues është z. Jetullah Mustafa, me banim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesi është Vendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 538/2008, i 28 qershorit 2011, që iu dorëzua parashtruesit më 20 shtator 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon që Vendimi i Gjykatës së Qarkut, nr. 89/98, i 9 shkurtit 1998, me anë të të cilit është pranuar kërkesa e tij për kompensim, për periudhën prej 3 dhjetorit 1993 e deri më 2 tetor 1998, të ekzekutohet në tërësinë e tij dhe jo pjesërisht, siç është bërë nga Gjykata Komunale deri më tash.
4. Parashtruesi më tej pohon se vendimi i Gjykatës Supreme, i 28 qershorit 2011, të cilin ai e pranoi më 20 shtator 2011, nuk ishte gjykuar në mënyrë të duhur dhe ishte i njëanshëm.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 dhjetor 2011, parashtruesi paraqiti një kërkesë në Gjykatë.
7. Më 17 janar 2012, Kryetari i Gjykatës, me Urdhrin nr. 164/11 GJR, caktoi Gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Urdhrin nr. 164/11 KSH, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Më 2 korrik 2012, Kryetari Enver Hasani zëvendësoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj në Kolegjin shqyrtues, mandati i së cilës, si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, kishte mbaruar më 26 qershor 2012.
9. Më 3 korrik 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 3 dhjetor 1993, ishte ndërprerë kontrata e punësimit të parashtruesit, punëtor i përhershëm në organizatën punuese të Kompanisë së Ujësjetës Rajonal "Batllava" në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: KUR).
11. Me Vendimin nr. 407/96, të 1 korrikut 1997, Gjykata e Qarkut në Prishtinë gjeti se marrëdhënia e punës së parashtruesit ishte ndërprerë në mënyrë të paligjshme. Ish-punëdhënësi i parashtruesit u ankua kundër këtij vendimi.
12. Më 9 shkurt 1998, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Ac. nr. 89/98, hodhi poshtë ankesën si të pabazuar dhe urdhëroi KUR-in që të rikthejë parashtruesin në vendin e mëparshëm të punës ose në ndonjë vend të ngjashëm pune. Të drejtat nga marrëdhënia e punës duhej të ruheshin patjetër.
13. Më 21 tetor 1998, parashtruesi u kthye në punë.

14. Më 12 shkurt 1999, Gjykata Komunale në Prishtinë miratoi kërkesën e parashtruesit për ekzekutimin e kërkesës për pagat që i detyroheshin atij, për periudhën ndërmjet 9 shkurtit 1998 dhe 21 shtatorit të të njëjtit vit.
15. Me letrën e 26 shkurtit 2001, drejtuar KUR-it, parashtruesi kërkoi kompensim për periudhën 3 dhjetor 1993 e deri më 21 tetor 1998. Një letër e datës 5 prill 2001 refuzoi kërkesën e tij.
16. Parashtruesi parashtrroi një kërkesë në Gjykatën Komunale të Prishtinës, më 26 dhjetor 2001, për kompensimin e dëmeve për mospagesën e rrogës gjatë kësaj periudhe.
17. Kjo ishte hedhur poshtë nga Gjykata Komunale në Prishtinë, me Vendimin C1. Nr. 545/2001, e 22 janarit 2003. Gjykata Komunale vendosi që parashtruesi ka humbur të drejtën për kompensim për rrogat e papaguara gjatë kësaj periudhe, me arsyetimin se me nenin 376 (1) të Ligjit për Obligimet, Statuti i Parashkrimit mundëson/lejon 3 vjet kompensimin e pagesës dhe parashtruesi ka qenë kështu 4 muaj e 17 ditë jashtë afatit kohor. Sidoqoftë, Gjykata Komunale nuk ka elaboruar se çfarë date kanë marrë parasysh për të ardhur në atë përfundim.
18. Më 17 shkurt 2005, me Vendimin CI. nr. 377/2004, Gjykata Komunale në Prishtinë hodhi poshtë kërkesën e mëtejme të parashtruesit për kompensim e pagës së papaguar prej 3 dhjetorit 1993 e deri më 21 tetor 1998, me arsyetimin se parashtruesit nuk i takonte kompensimi, pasi në saje të nenit 376 (1) të Ligjit për Obligimet, Statuti i Parashkrimit përcakton 3 vjet për të kërkuar kompensim. Parashtruesi u ankua kundër kësaj në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
19. Gjykata e Qarkut në Prishtinë hodhi poshtë ankesën e parashtruesit më 14 tetor 2005, me Vendimin Ac. nr. 521/2005. Dukej se Gjykata Komunale kishte vepruar drejt, duke vendosur për kërkesën e parashtruesit, sepse pagesat e mbetura ishin jashtë afatit kohor të përcaktuar me Statutin e Parashkrimit dhe duke marrë parasysh periudhën e bombardimeve nga marsi e deri në qershor 1999. Prandaj, Gjykata e Qarkut kishte konfirmuar Aktgjykimin CI. nr. 377/2004 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
20. Më 31 gusht 2007, parashtruesi kërkoi përsëritjen e procedurës së Gjykatës Komunale, duke propozuar Vendimin I. nr. 2074/98 të Gjykatës Komunale të 12 shkurtit 1999 (shih më lartë paragrafin 4) si evidencë të re.
21. Me vendimin CI. nr. 377/2004 (të 19 shtatorit 2007), Gjykata Komunale hodhi poshtë kërkesën, ndër të tjera, me arsyetimin se kishte skaduar afati kohor 30-ditësh, brenda të cilit duhej të dorëzohej kërkesa për përsëritjen e procedurës, që nga momenti i zbulimit të provave të cekura. Parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut.
22. Gjykata e Qarkut hodhi poshtë ankesën e parashtruesit, me Vendimin Ac. nr. 907/2007, e 27 gushtit 2008. Më pas, parashtruesi parashtrroi një kërkesë për shqyrtim në Gjykatën Supreme.
23. Më 28 qershor 2011, me Vendimin Rev. nr. 538/2008, Gjykata Supreme hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për shqyrtim, duke e konsideruar të pabazuar. Gjykata Supreme shprehej se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt afatin kohor për përsëritjen e procedurës – 30 ditë që nga zbulimi i provave të reja – dhe që, në fakt, kishte skaduar.
24. Parashtruesi mori vendimin e Gjykatës Supreme më 20 shtator 2011.

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesi kërkon përmbartimin e Vendimit Ac. nr. 89/98 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 9 shkurtit 1998, në të cilin KUR-i ishte urdhëruar të rikthejë parashtruesin në vendin e tij të punës, ose në një vend të ngjashëm pune.
26. Për më tepër, parashtruesi pretendon se, në Aktgjykimin e vet të 22 janarit 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka përmendur:
 - a. Prej cilës datë ka filluar të llogaritet periodha kohore e përcaktuar nga Statuti i Parashkrimit.
 - b. Si ka vendosur Gjykata shumën e kompensimit, e cila do t'i takonte parashtruesit.
27. Parashtruesi përfundimisht vë në pah se procedurat gjyqësore ishin të stërzgjatura dhe të padrejta dhe se, në mënyrë specifike, vendimi i Gjykatës Supreme, i 20 shtatorit 2011, ishte i njëanshëm dhe nuk ishte gjykuar si duhet.

Vlerësimi i papranueshmërisë së kërkesës

28. Nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi shihet se bëhet fjalë për dy grupe procedurash:
 - (1) Procedura që ka të bëjë me rrogat e papaguara, që ka përfunduar me vendimin Ac. nr. 521/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e 14 tetorit 2005, me të cilin u konfirmua Aktgjykimi Cl. nr. 377/2004 i Gjykatës Komunale në Prishtinë, i datës 17 shkurt 2005.
 - (2) Procedura që ka të bëjë me përsëritjen e procedurës, që ka përfunduar më 28 qershor 2011, me Vendimin Rev. nr. 238/2008 të Gjykatës Supreme.
29. Sa i përket procedurave nën a), Gjykata vëren se kanë ndërlidhje me ngjarjet para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Del se ankesa e parashtruesit është jashtë juridiksionit të Gjykatës dhe, kështu, në mospërputhje "*ratione temporis*" me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit (shih, *mutatis mutandis*, *Jasioniene v. Lithuania, kërkesa 41510198, Aktgjykimet e GJEDNJ-së, të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003, dhe Rasti nr. KI61/09, Adler Com vs. Urdhri i Kryetarit të Komunës Gjakovës*).
30. Sa i përket procedurave nën b), Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në vendimin e vet Rev. nr. 538/2008, të 28 qershorit 2011 (e pranuar nga parashtruesi më 20 shtator 2011) vendosi se gjykatat më të ulëta e kishin zbatuar drejt ligjin kur kanë vendosur për kërkesën për përsëritjen e procedurës, në pajtim me nenin 423 (1) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kjo kërkesë do të duhej të ishte dorëzuar brenda afatit 30 ditë nga dita kur pala ka pasur mundësinë të paraqesë fakte të reja.
31. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi nuk ka përmbushur kërkesën për pranueshmëri, të përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47.2 të Ligjit, sipas së cilës individët që parashtrojnë një kërkesë në Gjykatë duhet të tregojnë se kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore të përcaktuara me Ligj.

32. Arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse (duke përfshirë gjykatat) mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara kushtetuese (*Shih, mutatis mutandis, Selmouni kundër Francës, vendimi nr. 25803/94, i 28 korrikut 1999, dhe rasti KI41/09, Universiteti AAB –Rinvest kundër Qeverisë së Kosovës, Aktvendimi i 27 janarit 2010*).
33. Në rastin e parashtruesit, Gjykata vëren se gjykatat kanë përcaktuar, sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore, që parashtruesi ka iniciuar përsëritjen e procedurës jashtë afatit. Si rrjedhojë e kësaj, gjykatat ishin të parandaluara të merrnin parasysh provat e reja të dorëzuara rishtazi.
34. Në rrethana të tilla, Gjykata konkludon se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 56(2) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Ivan Čukalović



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

